VENDIM
Nr.8, datë 6.1.1997

PËR SHTESË SUBVENCIONI TË UJIT TË PIJSHËM

Me propozimin e Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në planin e buxhetit për vitin 1997, Ministrisë së Punëve Publike, Rregullimit të Territorit dhe Turizmit, i shtohen 15 milionë lekë për subvencionimin e ujit të pijshëm, që përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave për vititn 1997.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi